



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 13 shkurt 2018
Nr. ref.: RK 1198/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI26/17

Parashtrues

Raman Idrizi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, CML. nr. 14/2016, të 13 dhjetorit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Raman Idrizi nga Lubinje e Poshtme, komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës CML. nr. 14/2016 të 13 dhjetorit 2016, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga Prokurori i Shtetit kundër Aktvendimeve të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3114/2013 dhe C. nr. 593/2010, të 5 prillit 2016 dhe të 2 majit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 5 [Gjuhët], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 mars 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 07 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 12 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai ta dorëzojë formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumente shtesë.
8. Më 20 prill 2017, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.
9. Më 05 maj 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumentet e tjera të kërkuara.
10. Më 21 shtator 2017, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që ta plotësojë kërkesën dhe të qartësojë disa pyetje të caktuara precize lidhur me kërkesën e tij.
11. Më 10 tetor 2017, parashtruesi parashtrroi në Gjykatë përgjigjen e synuar në pyetje. Megjithatë, ai nuk iu përgjigj asnjë pyetjeje.
12. Më 8 nëntor 2017, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren të dorëzojë disa vendime lidhur me kërkesën e parashtruesit. Megjithatë, Gjykata Themelore në Prizren nuk është përgjigjur.

13. Më 11 janar 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 23 gusht 2010, ish-gruaja e parashtruesit të kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren për ta konfirmuar pronën e përbashkët të fituar në martesë; paditësi deklaroi shumën prej 50 euro si vlerë të kontestit.
15. Parashtruesi i kërkesës e kontestoi kërkesëpadinë e paditëses, por nuk e kontestoi shumën prej 50 euro si vlerë të kontestit të propozuar nga paditësja.
16. Më 10 mars 2011, Gjykata e atëhershme Komunale në Prizren [Aktgjykimi P. nr. 593/10] e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses.
17. Të dyja palët ndërgjyqëse parashtruan ankesë në Gjykatën e atëhershme të Qarkut në Prizren kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren.
18. Më 4 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut [Aktgjykimi Gž. nr. 355/2011] refuzoi të dyja ankesat dhe e vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë.
19. Më 13 shkurt 2013, përmes Gjykatës së tanishme Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për revizion, duke pohuar shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 2 maj 2013, Gjykata Themelore [Aktvendimi B. nr. 593/2010] e hodhi poshtë si të papranueshme kërkesën për revizion të parashtruesit, sepse *“vlera e deklaruar e kontestit është në shumën prej 50 €, dhe padyshim që revizioni i të paditurit (...) nuk lejohet dhe prandaj duhet të ishte refuzuar si i tillë në pajtim me nenin. 218 të LPK-së”*.
21. Parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën e Apelit ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe zbatimit të gabuar të dispozitave procedurale.
22. Më 5 prill 2016, Gjykata e Apelit [Aktvendimi AC. nr. 3114/2013] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore sepse *“vlera e kontestit është në shumën prej 50.00 €, dhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka hedhur poshtë revizionin e të paditurit, pasi revizioni nuk lejohet”*.
23. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i propozoi Prokurorit të Shtetit që të parashtrojë në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të ligjit për procedurën kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale.
24. Parashtruesi i kërkesës e njoftoi Prokurorin e Shtetit se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit nuk i ishte dorëzuar në gjuhën e tij amtare dhe u ankua se *“Gjykata e*

Apelit" [...] nuk i kushtoi vëmendje gjuhës sime amtare, duke pasur parasysh se unë e pranova vendimin në fjalë në gjuhën jo-amtare, që është një parakusht thelbësor i shkeljes së procedurës kontestimore".

25. Prokurori i Shtetit parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke pretenduar shkelje esenciale të ligjit për procedurën kontestimore.
26. Prokurori i Shtetit në mënyrë specifike pretendoi se vendimi i Gjykatës së Apelit nuk i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës në gjuhën e tij amtare, që pretendohet të ishte gjuha boshnjake, që është në kundërshtim me nenin 182 (2) (j) të LPK-së.
27. Më 13 dhjetor 2016, Gjykata Supreme [Aktvendimi CML. nr. 14/2016] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit duke konsideruar që *"kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e parashtruar nga Prokurori i Shtetit, nuk ka baza ligjore dhe është në kundërshtim me dispozitat e nenit 247 par. 1 (a) të LPK-së, duke pasur parasysh se shkeljet e përmendura në kërkesë (neni 6.2 në lidhje me nenin 182.2-j-) nuk paraqesin pengesë për çka paditësi mund të ketë pasur të drejtën të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pohon *"shkelje të parimeve të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës në nenin 5 - Gjuhët, 24 - Barazia para Ligjit dhe neni 31 - E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm"*.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkeljen e së drejtës për barazi para ligjit, sepse Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh *"çështjen shumë të rëndësishme që e definojnë vetë ankesën"*, që do të thotë *"deri në çfarë mase i padituri është përgjegjës se pse është vlera e kontestit është 50 euro"*.
30. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse Gjykata Supreme nuk i dha atij rast që *"të japë argumentet e tij për atë çështje shumë të rëndësishme"* me qëllim *"të përcaktimit të gjendjes faktike adekuate"*.
31. Parashtruesi i kërkesës më tutje pretendon shkelje të së drejtës së tij për përdorimin e gjuhës, sepse Gjykata Supreme *"e ka lënë pas dore përdorimin e gjuhës, duke shkelur seriozisht të drejtën e parashtruesit në gjuhë amtare"*. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar atij në një gjuhë që ai nuk e kupton.
32. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *"pas vlerësimit të pretendimeve të deklaruara në revizion (...) APPROVOHET revizioni i parashtruar, vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Apelit në Prishtinë 3114/2013 i 05.04.2016 NDRYSHOHET dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit REFUZOHET si i pabazuar"*.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës i cili përcakton:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh që:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendim i gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

36. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi është palë e autorizuar, ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit të caktuar.

37. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh që:

“Saktësimi i kërkesës Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

38. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]

d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

39. Gjkata rikujton se parashtruesi pretendon shkeljen e të drejtave të tij për barazi para ligjit, gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe përdorimin e gjuhës së tij, sepse Gjkata Supreme nuk ka marrë parasysh *“vlerën e kontestit prej 50 euro”*, nuk i dha atij rast që të *“japë argumentet e tij”* dhe *“ka lënë pas dore përdorimin e gjuhës”*
40. Gjkata vëren se Gjkata Supreme duke vlerësuar bazën e parashtruesit për të kërkuar mbrojtjen e ligjshmërisë, ka konsideruar se *“për parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të merren arsyet të cilat nuk janë, në mënyrë të qartë, të specifikuara në ligj”*, dhe ka gjetur se *“kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë (...)nuk ka mbështetje ligjore dhe është në kundërshtim me nenin 247 pika 1 (a) të LPK-së”*.
41. Qysh në fillim, Gjkata konsideron se parashtruesi nuk sqaron si dhe pse Gjkata Supreme ia ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese.
42. Përveç kësaj, Gjkata konsideron se vendimi i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe se procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, nuk ishin në asnjë mënyrë arbitrarë (shih, rasti i GJEDNJ, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykimi i 30 qershorit 2009).
43. Në lidhje me këtë, Gjkata rikujton se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *„Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
44. Gjkata përsërit se, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), *“nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventë. (Shih rasti i GJEDNJ Garcia Ruiz kundër Spanjës, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 Janarit 1999, § 28)”*.
45. Për më tepër, Gjkata përsërit se interpretimi dhe aplikimi i ligjeve janë në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta, dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjkata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (shih, rasti i GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; shih, po ashtu, *mutatis mutandis*, Gjkata Kushtetuese, rasti KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012).
46. Gjkata konsideron se është detyrë e parashtruesit që të dëshmojë dhe mbështesë pretendimet te tij për faktin se vendimi i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese. Kjo konsideratë është në pajtueshmëri me jurisprudencën e Gjykatës (shih, Gjkata Kushtetuese, rasti KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja, të 5 dhjetorit 2013).
47. Në lidhje me këtë, Gjkata rikujton se në pajtim me nenin 22 (4) të Ligjit parashtruesit të kërkesës i është kërkuar disa herë që të sqarojë dhe plotësojë

kërkesën e tij me dokumente shtesë. Megjithatë, ai nuk i ka respektuar kërkesat e Gjykatës në tërësi.

48. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës as nuk ka paraqitur fakte për të justifikuar pretendimin e tij se konkludimi ligjor i Gjykatës Supreme ishte në ndonjë mënyrë i padrejtë ose arbitrar dhe as nuk ka mbështetur pretendimin se ka pasur shkelje të të drejtave të tij për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për përdorimin e gjuhës së tij.
49. Gjykata gjithashtu konsideron se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit të tij. Megjithatë, mospajtimi nuk mund të ngre vetvetiu kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (shih, rasti GJEDNj *Mezitur Tiszazugi Tarsulat, kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
50. Gjykata më tej konsideron se kërkesa nuk i plotëson kushtet për procedim të mëtejshëm dhe është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
51. Prandaj, Gjykata konstaton se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të rregullores së Punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 janar 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi